

## Matësi i së vërtetës

7 Maj 2011

Deklarata: *Kur jemi te mediat në Kosovë, janë më të lirat apo janë më të hapurat, apo janë një mendim i lirë i prezantuar si pak më kun në rajon. Shiqoni Serbinë, shiqoni Malin e zi, Shqipërinë, Maqedoninë. Jemi më përpara.”*

Autor: Hashim Thaçi, Kryeministër i Kosovës

Data: 30 Nëntor 2010

Burimi: Klan Kosova<sup>1</sup>

Vlerësimi: E pavërtetë

Arsyetimi: Raporti i Freedom House për vitin 2009 e vendoste median në Kosovë si pjesërisht të lirë dhe me renditje më keq se mediat në Rajon. Ndryshe raporti i fundit i Freedom House për vitin 2010 e vendos Kosovën në vendin e 53-të pra e fundit në Ballkan për sa i përket lirisë së medias. Në renditjen e përgjithshme tabelor Kosova zë vendin e 108 për Lirinë e medias nga 196 vende sa janë në listën e raportit të Freedom House. Raporti përmend edhe presionin indirekt të Qeverisë në Media private dhe publike, mediat në funksion të qeverisë, madje edhe presionin e përbashkët të biznesit dhe qeverisë në media. Po ashtu edhe Asociacioni i Gazetarëve të Profesionist të Kosovës përmes një raporti thekson se mediet në Kosovë nuk janë të lirë.

---

Deklarata: **“Unë kam lajm të mirë për të gjitha mediumet elektronike dhe të shkruara, nga janari i vitit të ardhshëm do të lirohen nga TVSH-ja.”**

Autor: Hashim Thaçi, Kryeministër i Kosovës,

Data: 30 nëntor 2010

Burimi: Klan Kosova<sup>2</sup>

Vlerësimi: Premtim i pambajtur (*deri në datën e vlerësimit*)

Arsyetimi: Sigurisht që Kryeministri Thaci ka dhënë këtë premtim në kohën kur kishim vetëm një ditë që po fillonte fushata zgjedhore. Tash jemi në muajin maj 2011 dhe mediet nuk janë liruar nga TVSH-ja dhe as që kemi vërejtur ndonjë hap në këtë drejtim nga qeveria. Duket që kryeministri këtë premtim do ta mbaj për zgjedhjet e ardhshme sikurse shumë premtime të tjera.

---

<sup>1</sup> <http://klankosova.tv/index.php/zona-e-debatit/6390-hashim-thaqi-me-analiste.html>

<sup>2</sup> Po aty

**Deklarata:** “**Zotit Thaçi kurrë nuk do t’ia shtrijë dorën**”,  
**Autor:** Isa Mustafa, Kryetar i LDK-së,  
**Data:** 26 Dhjetor 2010,  
**Burimi:** gazetaexpress.com<sup>3</sup>  
**Vlerësimi:** E pavërtetë  
**Arsyetimi:** Jo vetëm që i shtriu dorën z. Thaçi, por edhe bëri marrëveshje për sic u tha për tejkalimin e krizës institucionale, për Presidenten e vendit, për ndryshimet Kushtetuese, si dhe për ndryshimet në sistemin zgjedhor.

---

**Deklarata:** “**Do të reduktojmë numrin e ministrive në 11, e pas disa viteve vetëm 6 ministri, qeverisja do të decentralizohet, jo në qendër**”  
**Autor:** Behxhet Pacolli, Kryetar i AKR-së  
**Data:** 07 Dhjetor 2010,  
**Burimi:** Top-channel.tv<sup>4</sup>  
**Vlerësimi:** E pavërtetë  
**Arsyetimi:** Edhe ky mbetet vetëm një premtim i pambajtur i zotit Pacolli dhe si rezultat sot kemi një qeveri, e cila i ofrohet Kuvendit të Kosovës me poste të ministrave dhe të zëvendës të tyre. Ndërkohë që, zoti Pacolli negocioj për disa javë për të marrë një vend të zëvendëskryeministrit, që çuditërisht ishin pesë të tillë dhe me këtë të fundit u bëne gjashtë. Vendi ka 18 ministri aktualisht, por me trendin e marrëveshjeve për koalicion shumë shpejt do të rriten në 19 të tilla.

---

**Deklarata:** “**Unë nuk kom ardh aty, unë pasurinë time që e kam, nuk e kom përfitu në Kosovë asnjë cent, ju e dini mirë**”  
**Autor:** Behxhet Pacolli, President  
**Data:** 17 Mars 2011,  
**Burimi:** Emisioni Jeta në Kosovë, RTK<sup>5</sup>  
**Vlerësimi:** E pavërtetë  
**Arsyetim:** E vërtetë është që pasuria e z. Pacolli nuk u krijua në Kosovë por deklarata tij se në Kosovë nuk ka përfituar asnjë cent është e pavërtetë. Z. Pacolli, respektivisht kompania e tij “Mabetex” ka rinovuar në të paktën dy projekte të mëdha që janë financuar nga buxheti publik. Pra, renovimet në Kuvendin e Kosovës dhe Ndërtesën e ish-Rilindjes, të cilat ishin kontrata milionëshe.

<sup>3</sup> <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,13,44197>

<sup>4</sup> <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=199454>

<sup>5</sup> <http://www.jetanekosove.com/shikovideo/731/Alb>